



Pompat e nxehtësisë

aroTHERM plus: komoditet i qëndrueshëm në shtëpinë tuaj.



10

VITE GARANCI

për kompresorin



Vaillant Rehati për shtëpinë time

Zbuloni energjinë e së ardhmes.



Pompat e nxehtësisë	4
Kriteret për zgjedhjen e produkteve	6
Përparësitë	8
Produktet tona	10
Pompa e nxehtësisë si pjesë e sistemit	14
Si punojnë pompat e nxehtësisë	16




Më shumë se 40 vjet
përvojë në prodhimin e
pompave të nxehtësisë

Që nga themelimi i kompanisë në 1874, kemi qenë të përkushtuar për të përmbushur nevojat e klientëve tanë. Sot, jemi përqendruar në përdorimin optimal të energjisë nga burimet e rinovueshme, në menaxhimin inteligjent të sistemeve të ngrohjes duke përdorur aplikacione celular dhe në rritjen e komoditetit, të gjitha në një vend dhe me cilësi të garantuar nga marka tradicionale gjermane. Jemi duke e përmbushur këtë premtim me pompat tona të qëndrueshme të nxehtësisë të gatshme për sfidat e së ardhmes.

Të gjitha produktet tona janë zhvilluar në Remscheid, prodhuar në Evropë dhe janë testuar në kushte ekstreme të motit në qendrat tona të testimit. Ditë pas dite, më shumë se 250.000 pompa nxehtësie të instaluar në të gjithë botën janë prova e besueshmërisë së tyre të jashtëzakonshme, efikasitetit energjetic dhe kostos efektive të tyre. Nuk i gjejmë vetëm në ndërtesat e reja, falë arritjeve të fundit të kompanisë Vaillant, pompat tona të nxehtësisë tani janë perfekte për instalim edhe në kuadër të projekteve të rinovimit të ndërtesave ekzistuese. Pompat e nxehtësisë mbrojnë mjedisin dhe ofrojnë atë që ka vërtetë rëndësi: komoditet në shtëpinë tuaj.



Të mira për mjedisin dhe portofolin tuaj.



Reduktimi i emetimeve të CO₂ - synim global

Në Konferencën e Parisit për Ndryshimin e Klimës, pothuajse të gjitha vendet pjesëmarrëse ranë dakord mbi synimin për të ulur në mënyrë efektive emetimet e tyre të CO₂. Në Gjermani, për shembull, sistemet e ngrohjes qendrore dhe ujit të nxehtë janë përgjegjëse për afërsisht 40% të të gjitha emetimeve të CO₂. Prandaj, programe të ndryshme stimuluese të qeverive kombëtare publikohen rregullisht. Stimujt jepen kryesisht për zgjidhjet teknologjike në lidhje me pompat e nxehtësisë. E gjithë kjo ndodh sepse marrja e energjisë nga burimet e rinovueshme është veçanërisht me kosto efektive kur përdoret në sistemet e ngrohjes.

Krahasuar me një kaldajë gazi me kondensë, një pompë nxehtësie mund të zvogëlojë emetimet e dioksidit të karbonit deri në 30%.

Më shumë qëndrueshmëri në shtëpinë tuaj

Gjithnjë e më shumë energji elektrike krijohet nga burimet e rinovueshme. Sipas rezultateve të një studimi të kryer në Universitetin Teknik të Mynihut (TU München), pompat e nxehtësisë do të prodhojnë 80% më pak CO₂ sesa kaldajat e gazit me kondensë deri në vitin 2030. Kjo e bën pompën e nxehtësisë llojin e vetëm të sistemit të ngrohjes që natyrshëm do të bëhet më i pranueshëm nga pikëpamja mjedisore sa më gjatë që të përdoret.

Ndërsa fatura juaj e ngrohjes do të ulet paralelisht me gjurmën tuaj të karbonit. Për shkak se teknologjia që keni zgjedhur është jashtëzakonisht efikase: rreth tre të katërtat e energjisë që konsumoni vjen nga mjedisi, plotësisht falas. Vetëm një e katërta e energjisë duhet të sigurohet në formën e energjisë elektrike të nevojshme për të funksionuar mekanizmi i pompës.



Kaloni në energji të rinovueshme

Le të shtojmë edhe këtë: Pompat e nxehtësisë Vaillant janë perfekte për instalim jo vetëm në zonat e reja të banimit por edhe gjatë modernizimit ose adaptimeve të ambienteve ekzistuese. Performancat e tyre janë pothuajse identike me ato të sistemeve të ngrohjes me naftë dhe gaz. Kjo do të thotë që pompat e nxehtësisë janë një zgjidhje perfekte për zëvendësimin e sistemeve ekzistuese të ngrohjes.

Të përshtatshme për

MODERNIZIM

Pompat e nxehtësisë: fakte dhe shifra

50%

është rritje e numrit të pompave të nxehtësisë të instaluara në Gjermani gjatë pesë viteve të fundit.

Burimi:
Bundesverband Wärmepumpe e.V.



Gati

100.000



pompa nxehtësie të instaluara në Gjermani vetëm në vitin 2018.

Burimi:
Bundesverband Wärmepumpe e.V.

44%

është pjesa e ndërtesave të reja të banimit të ndërtuara në Gjermani të pajisura me pompa nxehtësie në vitin 2018. Kështu, pompat e nxehtësisë kanë marrë vendin e parë.

Burimi:
Bundesverband Wärmepumpe e.V.



54 t

kursim CO₂ gjatë 20 viteve përdorimi të pompës së nxehtësisë krahasuar me përdorimin e një kaldaje gazi me kondensë.

Burimi: Vaillant



aroTHERM plus - zgjidhja që kërkonit

Pavarësisht nëse bëhet fjalë për një ndërtesë të re apo një ndërtesë të vjetër - pompa e nxehtësisë është gjithmonë zgjedhja e duhur. Sot, sistemet e tilla si aroTHERM plus mund të kombinohen me sistemet e ngrohjes në dysheme, ashtu edhe me radiatorët.

Të përshtatshme
për

MODERNIZIM



Të përsosura për zonat e reja të banimit

Nevojat tuaja për ngrohje në një ndërtesë të re do të jenë të ulëta për shkak të detyrimit ligjor të izolimit termik të ndërtesave. Pjesa më e madhe e energjisë së nevojshme të nxehtësisë do të përdoret për ngrohjen e ujit në shtëpi. Të gjitha modelet e pompave tona të nxehtësisë tregojnë performanca të shkëlqyeshme në këtë pikëpamje dhe lejojnë, për shembull, përdorimin e dusheve vertikale. Pompat e nxehtësisë janë veçanërisht efikase në kombinim me sistemet e ngrohjes në dysheme.

Meqenëse sistemi ka edhe një funksion ftohës, ai ju mundëson të ruani temperatura të rehatshme në shtëpinë tuaj edhe gjatë muajve të verës.




Të përshtatshme për modernizim në objektet ekzistuese

Performanca e modeleve më të fundit të pompave të nxehtësisë është e ngjashme me sistemet e ngrohjes me lëndë djegëse fosile. Duke pasur parasysh të lartpërmendurat, ato janë perfekte për zëvendësimin e sistemeve ekzistuese të ngrohjes me lëndë djegëse fosile me ato nga burimet e rinovueshme të energjisë.

Në modernizime, instalimi i ngrohjes në dysheme nuk është gjithmonë i mundur. Pavarësisht nga ky problem, pompat e nxehtësisë të tilla si aroTHERM plus e re, sidoqoftë janë zgjedhja e duhur. Falë temperaturës së lartë të rrjedhjes dalëse deri në 75°C, sistemi mund të kombinohet me ngrohjen e radiatorit. Thjesht pyesni projektuesin e autorizuar ose partnerin e instaluesit të Vaillant për të përcaktuar se cila pompë nxehtësie është zgjidhja më e mirë për ju.



Ndërtesë banimi **Shtëpi në varg në një ngastër të vogël toke** **Ndërtesë e veçuar në një ngastër të madhe toke**



Ndërtesat e reja			
Modernizimet	Vlerësimi individual i burimit perfekt të energjisë		

Burimet e energjisë: Ajri Toka Uji

Faktor vendimtar është vendndodhja e shtëpisë tuaj

Burimet nga ajri, uji ose toka: zgjedhja e burimit tuaj më të mirë të energjisë varet nga disa kushte. Së pari, për përdorimin e ujit të kripur ose të zakonshëm vendndodhja duhet të jetë e një madhësie të caktuar dhe e përshtatshme për aksesin e automjeteve. Nga ana tjetër, pompat tona të nxehtësisë aroTHERM falë punës pa zhurmë të pompës së nxehtësisë që punon me ajër, mund të instalohen edhe në ambiente të vogla. Do të ishte më së miri të kontaktoni një projektues ose instalues të specializuar për sisteme ngrohjeje dhe ftohjeje për të përcaktuar se cili sistem është më i përshtatshmi për nevojat tuaja.


6 arsye bindëse për aroTHERM plus.

Pse pompa e nxehtësisë është zgjidhja më e mirë për ngrohjen, ftohjen dhe përgatitjen e ujit të ngrohtë?




Pompa e nxehtësisë sjell kosto më të ulët të ngrohjes dhe emetime më të ulëta CO₂ sesa sistemet e ngrohjes me gaz dhe vaj. Ju mund të kurseni edhe më shumë duke prodhuar energjinë elektrike me përdorimin e një sistemi fotovoltaik. Instalimi i sistemit është i thjeshtë dhe nuk kërkon mundim të madh.

Pompat e nxehtësisë Vaillant janë ndër më silenciozet në treg. Sistemi Sound Safe siguron që as ju dhe as fqinjët tuaj të mos shqetësohen nga zhurma. Në një distancë prej tre metrash, zhurma e njësive të jashtme mund të krahasohet me shushurimën e qetë të gjetheve, gjë që i bën ato të përshtatshme për instalim edhe në zona të populluara dendur me shtëpi në varg njëra pas tjetrës.



Njësia e jashtme e pompës së nxehtësisë ajër/ujë aroTHERM plus

Edhe njësia e brendshme dhe ajo e jashtme janë shumë kompakte në madhësi - krahasuar në radhë të parë me rezervuarët e vajgurit dhe të kaldajave me vaj. Madhësia e njësive të brendshme është përafërsisht sa një frigorifer me ngrirës, dhe zë shumë pak vend të ambientit tuaj të jetesës.



Pompat e nxehtësisë janë të përsosura për modernizime. Falë temperaturës së lartë të rrjedhjes, pajisjet aroTHERM plus janë një zgjidhje veçanërisht e mirë për zëvendësimin e sistemeve të ngrohjes me gaz dhe vaj.



uniTOWER
me rezervuar të integruar për ujë të ngrohtë

Të përsosura për modernizime



I gjithë sistemi mund të menaxhohet nga një aplikacion celular. Kjo do të thotë se mund të integrohet gjithashtu në një nga sistemet e shtëpive inteligjente, të tilla si KNX.

Lidhshmëri




KNX
sistemi



Të gjitha pompat e nxehtësisë mund të kombinohen me komponentë shtesë. Sillni një frymë ajri të freskët në ambientet tuaja me sistemin e ventilimit të kontrolluar recoVAIR, gjeneroni energjinë tuaj elektrike me sistemin fotovoltaik auroPOWER dhe siguroni ujë të ngrohtë sanitar me sistemin e kolektorëve diellor auroTHERM.

Zgjerim fleksibël



Linja auroTHERM: energjia e re nga ajri.



Sistemet e pompave të nxehtësisë të linjës së produkteve aroTHERM kujdesen për ngrohjen, ftohjen dhe nevojat tuaja për ujë të ngrohtë. Janë po aq perfektë për instalim në ndërtesat e reja, sikurse dhe për zëvendësimin e sistemeve ngrohëse në objektet e vjetra.

Dy komponentë për një sistem efikas

Çdo sistem aroTHERM përbëhet nga dy njësi: një pompë nxehtësie e instaluar jashtë dhe një njësi e brendshme që ne e quajmë uniTOWER. Pompa e nxehtësisë vendoset në oborr në një vend që nuk bie në sy, krah murit të shtëpisë ose në çati. Njësia hidraulike uniTOWER mund të instalohet në çdo vend të përshtatshëm në shtëpinë tuaj.

Të gjitha në një: njësia kompakte uniTOWER

Madhësia e njësive uniTOWER afërsisht korrespondon me madhësinë e një frigoriferi. Gëzoni pa rrëmujë ambientin ku është vendosur instalimi dhe kurseni hapësirën e metrave katrorë të shtrenjtë, veçanërisht në ndërtimet e reja. Kapaciteti i rezervuarit të ujit të ngrohtë është 190 litra, dhe siguron nevojat për ujë të ngrohtë për një familje me pesë anëtarë.



Sistemi përbëhet nga një njësi e jashtme aroTHERM plus dhe një njësi hidraulike uniTOWER



Njësia aroTHERM split në kombinim me njësinë hidraulike, rregullimin dhe me rezervuarin për ujë të ngrohtë

Për një furnizim më komod me ujë të ngrohtë

Nëse keni nevojë për më shumë ujë të ngrohtë, moduli hidraulik i murit mund të përdoret në kombinim me një rezervuar më të madh të ujit të ngrohtë. Integrimi i sistemit termik diellor është gjithashtu i mundur.

Një koncept - dy teknologji të ndryshme

Sistemet aroTHERM janë në dispozicion në dy versione të ndryshme teknologjike: monoblok dhe split. Në sistemin monoblok, të gjithë përbërësit e pompës së nxehtësisë janë të vendosur në njësinë e jashtme. Në sistemin aroTHERM split - siç sugjeron dhe vetë emri - përbërësit ndahen midis njësive së jashtme dhe asaj të brendshme. Kondensatori ndodhet në njësinë e brendshme. Instaluesi juaj Vaillant do t'ju këshillojë për zgjidhjen më të mirë për shtëpinë tuaj.

aroTHERM split dhe aroTHERM plus.



Të përsosura për modernizime

Pompat e nxehtësisë janë zgjedhja e duhur për pothuajse çdo objekt. Në ndërtesat e vjetra, sistemi aroTHERM plus është zëvendësimi perfekt i qëndrueshëm energjistik i sistemit ekzistues. Lënda natyrale ftohëse mundëson një temperaturë veçanërisht të lartë të rrjedhjes deri në 75°C. Kjo do të thotë që aroTHERM plus mund të përdoret në kombinim me radiatorët dhe të ofrojë performanca të ngjashme me sistemet e ngrohjes me naftë dhe gaz.

Instalim i shpejtë në projektet e rinovimit

Sistemi mund të instalohet nga një deri në tre ditë pa ndonjë ndryshim të rëndësishëm strukturor. Në këtë mënyrë do të keni më pak shpenzime për materialet dhe punën.

Punë pa zhurmë

Ndërsa pompa e nxehtësisë punon, niveli i zhurmës që ajo lëshon gati nuk vërehet në një distancë prej disa metrash dhe mund të krahasohet me zhurmën e ventilatorit në një kompjuter personal. Kjo është arsyeja pse ky sistem është po aq i përsosur për ndërtesat më të populluara si p.sh. shtëpitë e ngjitura në varg.

Inovative dhe mbresëlënëse nga ana vizuale me çmime tërheqëse

Sistemet aroTHERM split dhe aroTHERM plus sigurojnë një raport të bukur dhe elegantë çmim - cilësi, dhe krahas kësaj duken shkëlqyeshëm. Të dy sistemet kanë fituar një numër çmimesh për dizajnin e tyre të suksesshëm. Kur bëhet fjalë për inovacionin, aroTHERM plus është vlerësuar si një nga produktet më të mira në panairin Interclima dhe si të tillë e ka vlerësuar edhe revista franceze për rinovim dhe dizajn interieri Maison & Travaux.

	aroTHERM plus	aroTHERM Split
Burim i nxehtësisë:	Duhet vetëm disa metra distancë nga prona fqinje	
Projektuar për	ndërtesa të reja, rinovime, zëvendësime	ndërtesa të reja, rinovime
Sistemi i ngrohjes në shtëpi	sistemet me radiatorë dhe ngrohje në dysheme	sistemet me radiatorë me temperatura të ulëta dhe ngrohje në dysheme
Madhësia e objektit	deri në 470 m ² te ndërtesat e reja	
Hapësira e duhur brenda	1,5 m ² me modulën uniTOWER 2,20 m ² me modul hidraulik muri dhe me rezervuar	
Uji i ngrohtë	deri në 5 persona	
Efikasiteti energjistik	ngrohja: A+++/A++ (A+++ - D)	

Përparësitë e sistemit aroTHERM split dhe aroTHERM plus

- Komoditet dhe praktikitet i jashtëzakonshëm me një çmim tërheqës
- aroTHERM plus një zgjidhje e qëndrueshme e modernizimit
- Nota më e lartë për efikasitetin energjistik
- Nivel shumë i ulët i zhurmës, i përshtatshëm për shtëpitë e ngjitura në varg
- Instalim i shpejtë që kursen hapësirën tuaj



aroTHERM plus: për rinovim të pranueshëm ekologjikisht.



Lëndë natyrore
ftohëse GWP 3

Nëse keni ndërmend të kaloni nga një sistem i vjetër ngrohjeje në një burim ngrohjeje të pranueshëm ekologjikisht, mund ta bëni këtë shumë lehtë me sistemin aroTHERM plus. Pompa e re e nxehtësisë ajër/ujë kombinon performancat e fuqishme, efikasitetin e energjisë dhe qëndrueshmërinë.



Të përshtatshme
për
MODERNIZIM

Teknologjia më e fundit e prodhimit të pompës së nxehtësisë

Sistemi aroTHERM plus përdor lëndë ftohëse natyrore të pranueshme ekologjikisht. Njëkohësisht, kjo teknologji mundëson një temperaturë veçanërisht të lartë të rrjedhjes deri në 75°C. Kjo do të thotë që sistemi aroTHERM plus mund të përdoret edhe për adaptime në kombinim me radiatorët ekzistues në objektet ekzistuese të vjetra.

Një mënyrë shumë praktike për përgatitjen e ujit të ngrohtë.

Për shkak të performancave të tij jashtëzakonisht të larta, aroTHERM plus ofron gjithashtu një mënyrë shumë praktike të përgatitjes së ujit të ngrohtë. Në krahasim me pompat e tjera të nxehtësisë, sistemi aroTHERM plus ofron deri në 25 përqind më shumë ujë të ngrohtë në ndërtesat e reja dhe ato më të vjetra. Një avantazh shtesë është mbrojtja kundër legjionelës pa nevojën e instalimit të një ngrohësi elektrik shtesë. aroTHERM plus, si të gjitha pompat e tjera të nxehtësisë aroTHERM, mund të kombinohet me njësinë hidraulike uniTOWER që kërkon një hapësirë minimale.

Rezervuari i ujit të nxehtë mund të zgjidhet si një variant fleksibël për të gjithë ata që duan dushe të gjata, për ata që duan dushe vertikale dhe për anëtarët e tjerë të familjes.

Efikasiteti i jashtëzakonshëm energjetik

Klasa e efikasitetit të energjisë A+++ do të thotë që do të keni një nga pajisjet shtëpiake më efikase të energjisë në shtëpinë tuaj. Në varësi të kërkesave tuaja, do të jeni në gjendje të zvogëloni konsumin e energjisë me më shumë se 10%.

Paraqitje e shkurtër e avantazheve

- Zëvendësim i përshtatshëm i ngrohjes me vaj ose gaz
- Instalim pa ndryshime strukturore të mëdha
- Punë me shumë pak zhurmë, si edhe pompat e tjera të nxehtësisë Vaillant
- Përdorim i thjeshtë dhe praktik
- Përdorim edhe me një aplikacion të caktuar celular

* Kursimet e realizuara ose të arritura të energjisë varen nga një numër faktorësh (p.sh. modelet lokale të tarifave të energjisë elektrike, modeli i pajisjeve të përdorura më parë, cilësimet e ngrohjes, mënyra e përdorimit, vendndodhja e instalimit, temperatura e jashtme) dhe ndërveprimi i tyre mund të çojë në devijimin e rezultateve të kursimit.

E përshtatshme edhe për objektet e vjetra.


Në përgjithësi, viti i ndërtimit i objektit dhe sipërfaqja e hapësirës së jetesës që do të nxehet, janë faktorët vendimtarë në përcaktimin e përshtatshmërisë së sistemit aroTHERM plus për planet tuaja të modernizimit. Një kriter dhe kusht i rëndësishëm është edhe gjendja e objektit që rinovohet - p.sh. kapaciteti i izolimit të dritareve. Do të ishte më mirë të konsultoheni me një ekspert për këshillë, p.sh. me një inxhinier të certifikuar ose me partnerin e instalimit Vaillant.

Rregulli i përgjithshëm është:

Sa më e re të jetë ndërtesa, aq më të ulëta janë kërkesat për ngrohje, dhe aq më e madhe është hapësira e banimit që mund të ngrohet në mënyrë efikase nga një pompë nxehtësie.

Hapësira e banimit në m², të ngrohur me pompë

Viti i ndërtimit



Instalim i shpejtë

Instalimi i sistemit aroTHERM plus kryhet për vetëm disa ditë. Për më tepër, nuk kërkohet pothuajse asnjë përpjekje për të bërë ndryshime strukturore.



Mund të kombinohet me çdo pajisje tjetër ngrohëse

Sistemi aroTHERM plus mund të përdoret edhe si një burim i pavarur i nxehtësisë. Sidoqoftë, mund ta integroni këtë zgjidhje në sistemin tuaj ekzistues të ngrohjes ose ta kombinoni atë si pjesë e një sistemi hibrid me një pajisje tjetër ngrohëse.



Pothuajse pa zhurmë

Me një nivel zhurme prej vetëm 28 dB (A) në një distancë prej tre metrash në regjimin e punës të natës, aroTHERM plus është po aq i silencioz sa një orë dore. Falë kësaj, sistemi mund të instalohet në çdo vend, madje edhe në vendbanimet e ndërtuara dendur si p.sh. shtëpitë e ngjitura në varg.

	aroTHERM plus
Burim i nxehtësisë: ajri	duhen vetëm disa metra distancë nga prona fjinje
Përdorimi	ndërtesa të reja, rinovime, zëvendësime
Sistemi i ngrohjes në shtëpi	sistemet me radiatorë dhe ngrohje në dysheme
Madhësia e objektit	deri në 470 m ² te ndërtesat e reja
Hapësira e duhur brenda	1,5 m ² me modulën uniTOWER 2,20 m ² me modul hidraulik muri dhe me rezervuar
Uji i ngrohtë	deri në 5 persona
Efikasiteti energjitik	Ngrohja: A+++/A++ (A+++ - D)




Zgjerim efikas i sistemit.

Me secilin sistem të pompës së nxehtësisë Vaillant, ju ndihmoni në ruajtjen e burimeve natyrore dhe siguron që të shijoni përfitimet e shumta të komoditetit të jetesës për shumë vite që do të vijjnë. Ju mund të rrisni më tej qëndrueshmërinë dhe kursimin e sistemit tuaj duke integruar dhe duke përdorur burime shtesë të rinovueshme të energjisë. Ne ju ofrojmë mundësi të shumta të zgjerimit të sistemit. Teknologjia e menaxhimit inteligjent garanton integrimin perfekt të të gjithë komponentëve dhe lejon përdoruesin të manovrojë me lehtësi sistemin.



Modulët fotovoltaike

Prodhoni energjinë tuaj elektrike dhe kurseni më shumë me sistemin e moduleve fotovoltaike auroPOWER. Në këtë mënyrë, do të siguron një pjesë të energjisë elektrike të nevojshme për funksionimin e pompës së nxehtësisë, dhe të bëheni më pak i varur nga furnizuesit e energjisë elektrike, sikurse dhe më i vëmendshëm ndaj mjedisit dhe portofolit tuaj.



Ventilimi i kontrolluar në shtëpi

Shijoni ajrin e pastër në çdo kohë me sistemin tonë të ventilimit recoVAIR. Të keni një sistem ventilimi në ndërtesat e izoluar mirë, është e domosdoshme. Zgjidhjet tona të sistemit të ventilimit të centralizuar dhe të decentralizuar ju lejojnë të përmbushni me lehtësi këtë domosdoshmëri.



Energjia diellore termike

Përgatitja e qëndrueshme e ujit të nxehtë është e mundur me sistemin tonë diellor auroTHERM. Gjatë muajve të verës, në ditët me diell, do të jeni në gjendje të siguroni ujë të nxehtë madje plotësisht falas. Pompa e nxehtësie mund të bëjë pushimin e merituar dhe ju mund të kurseni një shumë të konsiderueshme parash. Sigurisht, ju gjithashtu mund të përdorni sistemin tonë auroTHERM për të mbështetur sistemin e ngrohjes qendrore.



Ftohja me ventil-konvektorë

Gëzoni një hapësirë të kondicionuar në mënyrë të përsosur gjatë gjithë vitit me ventil-konvektorët tanë aroVAIR. Ato plotësojnë në mënyrë të përsosur të gjitha pompat tona të nxehtësisë dhe mbajnë një temperaturë të rehatshme të ambientit në çdo kohë - si gjatë ftohjes ashtu edhe gjatë ngrohjes.




Rezervuar për përgatitjen e ujit të ngrohtë për konsum



Zbuloni komoditetin e përgatitjes së ujit të nxehtë që u përshtatet në mënyrë të përkryer nevojave tuaja. Rezervuarët tanë të ujit të ngrohtë sanitar janë përshtatur posaçërisht për të punuar me pompat tona të nxehtësisë, për të arritur vlerësimet më të larta të efikasitetit të energjisë - pa humbje të nxehtësisë.

Si funksionon sistemi efikas i ngrohjes.

Cikli perfekt

Pompa e nxehtësisë thith nxehtësinë e diellit nga ajri, toka ose ujërat nëntokësore. Mirëpo, temperatura natyrore e nxehtësisë së ambientit është shumë e ulët për nevojat e ngrohjes. Në mënyrë që të rritet kjo temperaturë, në sistemin e pompës së nxehtësisë qarkullon lënda ftohëse me pikë shumë të ulët vlimi. Brenda një rrethi të mbyllur, ajo i nënshtrohet vazhdimisht të njëjtit proces në katër hapa.




 Temperatura e ulët
 Temperatura e lartë

4
Zgjerimi:
Lënda ftohëse akoma shumë e kompresuar, zgjerohet në valvulën e zgjerimit dhe ftohet ndjeshëm gjatë këtij procesi. Tani mund të ri-absorbojë energjinë nga mjedisi dhe cikli fillon nga e para.

E shkëlqyeshme edhe për ftohje.

Pompat e nxehtësisë nuk përdoren vetëm për ngrohjen e shtëpisë suaj dhe përgatitjen e ujit të nxehtë në muajt e verës, ky sistem e mban shtëpinë tuaj edhe të freskët këndshëm. Ky funksion është i integruar tashmë në pajisje, kështu që nuk ka asnjë kosto shtesë ose nevojë për të instaluar kondicionerë të veçantë.

Ju mund të arrini temperaturën e ambientit që ju përshtatet më shumë në dy mënyra të ndryshme: drejtpërdrejt me sistemin e ngrohjes në dysheme ose me ventil-konvektorët. Ftohja me ventil-konvektorë është veçanërisht efikase.









Mënyra e punës së ftohjes:

Pompa e nxehtësisë aroTHERM ajër/ujë - ftohje aktive

Funksioni i ftohjes është i integruar tashmë në pompat tona të nxehtësisë ajër/ujë. Punon sipas parimit të kundërt nga qarku i ngrohjes së sistemit, me fjalë të tjera, në vend që të qarkullojë ujë të nxehtë gjatë dimrit - në sistem qarkullon uji i ftohtë gjatë verës. Ngjashëm me parimin e funksionimit të frigoriferit.

Aksesorë

	Emërtimi i produktit	Përshkrimi
	VWZ AI MB7	moduli i kontrollit
	sensoCOMFORT VRC 720	rregullator kompleks i programueshëm me ekran me prekje
	multiMATIC VRC 700/6	rregullator i programueshëm
	sensoNET VR 921	njësi komun. për menaxhim nëpërmjet internetit
	VR 32/B	modul për lidhje kaskadë
	VIH QW 190/6 MB7	uniTOWER modul pa ngrohës
	VIH QW 190/6 E MB7	uniTOWER modul me ngrohës
	VWZ MEH 97/6 MB7	Stacion hidraulik për integrim të shpejtë

Të dhënat teknike

aroTHERM plus monoblok

Përshkrimi	Njës.	VWL 45/6 A S3	VWL 55/6 A S3	VWL 65/6 A S3	VWL 85/6 A S3	VWL 125/6 A S3	VWL 125/6 A S3	VWL 155/6 A S3	VWL 155/6 A S3
Lidhja elektrike		230V/ 50Hz	230V/ 50Hz	230V/ 50Hz	230V/ 50Hz	230V/ 50Hz	400V/ 50Hz	230V/ 50Hz	400V/ 50Hz
Efekt i ngrohës A7/W35 (min/nom/max)	kW	2,2 /4,1/ 6,3	2,1/ 4,2/ 8,1	3,1/ 5,1/ 9,1	2,9/ 7,8/ 10,9	5,5/ 11,6/ 15,6	5,5/ 11,6/ 15,6	5,5/ 14,3/ 18,7	5,5/ 14,3/ 18,7
Koeficienti i performancës në ngrohje COP (A7/W35)		deri në 4,8	deri në 4,5	deri në 4,8	deri në 4,8	deri në 5,3	deri në 5,3	deri në 5,1	deri në 5,1
Koeficienti sezonal i efikasitetit në ngrohje SCOP		4,57	4,5	4,72	4,75	5,08	5,08	4,75	4,74
Klasa e efikasitetit të energjisë në ngrohje (kushtet mesatare klimatike); temp. e rrjedhjes 35°C		A+++	A+++	A+++	A+++	A+++	A+++	A+++	A+++
Temperatura minimale e ajrit të mjesdit për ngrohje	°C	-25	-25	-25	-25	-25	-25	-25	-25
Efekt i ftohjes A35/W18 (min/nom/max)	kW	2,4/ 4,5/ 7,3	2,4/ 4,5/ 7,3	3,6/ 6,4/ 11,0	3,6/ 6,4/ 11,0	6,0/ 10,9/ 18,0	6,0/ 10,9/ 18,0	6,0/ 10,8/ 18,0	6,0/ 10,8/ 18,0
Koeficienti i performancës në ftohje EER (A35/W18)		deri në 5,4	deri në 5,4	deri në 5,4	deri në 5,4	deri në 5,7	deri në 5,7	deri në 5,7	deri në 5,7
Temperatura minimale e ajrit të mjesdit për ftohje	°C	15	15	15	15	15	15	15	15
Temperatura e rezervuarit të UNK-së	°C	deri në 70 pa ngr. shte.	deri në 70 pa ngr. shte.	deri në 70 pa ngr. shte.	deri në 70 pa ngr. shte.	deri në 70 pa ngr. shte.	deri në 70 pa ngr. shte.	deri në 70 pa ngr. shte.	deri në 70 pa ngr. shte.
Temp. maksimale e ujit të ngrohtë pa përdorimin e ngrohësit	°C	deri në 75	deri në 75	deri në 75	deri në 75	deri në 75	deri në 75	deri në 75	deri në 75
Temp. maks. e mundshme e ujit të ngr. të vendoset në rregullator	°C	deri në 65	deri në 65	deri në 65	deri në 65	deri në 65	deri në 65	deri në 65	deri në 65
Përmasat e produktit (L x GJ x GJ)	mm	1100 x 765 x 450	1100x 765x 450	1100 x 965 x 450	1100 x 965 x 450	1100 x 1565 x 450	1100 x 1565 x 450	1100 x 1565 x 450	1100 x 1565 x 450
Përmasat e lidhjeve		G 1 1/4"	G 1 1/4"	G 1 1/4"	G 1 1/4"	G 1 1/4"	G 1 1/4"	G 1 1/4"	G 1 1/4"
Pesha e produktit	kg	114	114	128	128	194	210	194	210
Niveli i mbrojtjes		IP 15 B	IP 15 B	IP 15 B	IP 15 B	IP 15 B	IP 15 B	IP 15 B	IP 15 B
Niveli i zhurmës në largësi më të madhe se 3 metra nga pompa e nxehtësisë gjatë regjimit të punës gjatë natës	dB	28,9	28,9	28,7	28,7	33,5	33,4	33,5	33,4
Niveli i zhurmës në largësi më të madhe se 3 metra nga pompa e nxehtësisë gjatë regjimit të punës gjatë ditës	dB	37,9	37,9	43,4	43,4	45,9	45,8	45,9	45,8
Lloji i lëndës ftohëse		R 290	R 290	R 290	R 290	R 290	R 290	R 290	R 290
GWP (potenciali i ngrohjes globale)		3	3	3	3	3	3	3	3




Ngrohje



Ftohje



Energji të reja



EU Ecolabel:
2011/333/EC